

## Vlerësimi i Aksesit në Furnizimin më Ujë të Pijshëm dhe Largimin e Ujerave të Ndotura

### Konteksti i projektit

Akoma vendi ynë është i ekspozuar ndaj problemeve aktuale mjedisore që lidhen më keq menaxhim të mbetjeve, mungesën e aksesit të banorëve/bizneseve me sistemin e kanalizimeve dhe derdhje të ujërave të ndotura në rrymat ujore, moskujdesjes ndaj hapësirave publike, ndotjet e mjedisit urban tej normave të lejuara etj. Gjithashtu kohet e fundit qeveria shqiptare për shkak të situatës së rënduar mjedisore ka shpallur situatën e emergjencës mjedisore. Në fazën e parë dhe të dytë të programit SENIOR-A është bërë një analizim dhe vlerësim i shërbimeve mjedisore, ku nga problemet kryesore që u evidentuan ishte furnizimi më ujë të pijshëm dhe largimi i ujerave të ndotur. Megjithëse Shqipëria është një vend shumë i pasur me rezerva ujore, uji i pijshëm ka qenë një ndër problemet më prezente për qytetarët. Furnizimi me orare të reduktuara, ulja e presionit dhe higjiena si rrjedhojë e amortizimit të rrjetit duken si probleme të cilët kërkojnë shumë investime dhe kohe që të zgjidhen.

### Qëllimi i projektit

Nën këtë kontekst, rrjeti i shoqërisë civile për menaxhimin e shërbimeve mjedisore kupton që informacioni që siguron Enti Rregullator i ujit në lidhje me sigurimin e shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, në të dyja rastet atë Rural dhe atë Urban, si dhe studime të nevojave primare të banorëve në këto zona, ka nevojë të përmirësohet dhe të zgjerohet, në këtë mënyrë zgjidhet sfida për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurohet mbrojtja e mjedisit.

### Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur/ Fondacioni Soros, etj.



### Objektivat e projektit

- Përdorimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të rrjetit të përfituara gjatë fazës së dytë të projektit më interes informimin e qytetarëve dhe niveleve të ndryshme të qeverisjes në lidhje me nivelin dhe cilësinë e shërbimit të sigurimit të ujit të pijshëm dhe të largimit të ujërave të ndotura.
- Përditësimi dhe përmirësim i bazës së të dhënave të autoriteteve përkatëse si dhe dhënia e prioritetit të zgjidhjes së problemeve më emergjente nga këto autoritete.
- Rritja informimit publik në lidhje me ofrimin e këtyre shërbimeve nga ana e ndërmarrjeve UK sh.a.
- Mbështetje dhe përgjithësim i ekspertizës së rrjetit në vlerësimin e nivelit të aksesit të popullsisë në rrjetin e furnizimit me ujë dhe të largimit të ujërave të ndotura si dhe hartëzimi e përqindjeve të aksesit në këto shërbime.

### Aktivitetet e projektit

- Workshop /trajtime për aktivizimin e rrjetit për zbatimin e projektit dhe ngritje kapacitetesh në aftësimin e grupeve në procesin e monitorimit/vlerësimit të situatës së furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura.

- Tryeza të rrumbullakëta për koordinime dhe bashkëpunime vendore/qendrore në rrjet dhe përdorimi i ekspertizës së punës në rrjet.
- Identifikim dhe rishikim i studimeve ekzistuese të cilat kanë në konsideratë plotësisht ose pjesërisht sigurimin e këtij shërbimi.
- Analiza e situatës aktuale në qytetet anëtare të rrjetit në lidhje me nivelin e aksesit të banorëve me ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura më anë të një pyetësori të përbashkët për të gjitha qytetet.
- Raportime të hapura për gjetjet dhe rezultatet si dhe priorizim i problematikave më urgjente.
- Hartëzimi me anë të sistemit GIS të nivelit të aksesit të banorëve në secilën zonë me shërbimet e mësipërme.
- Publikim i gjetjeve të situatës aktuale dhe analizës krahasimore për të gjitha qytetet anëtare të rrjetit.

### Rezultatet e pritshme

- Rritet bashkëpunimi në rrjet për të shfrytëzuar eksperiencat dhe kapacitetet individuale.
- Përmirësohen të dhënat në çdo rajon mbi shërbimin e aksesit në ujë të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura.
- Rritet interesi i aktoreve për t'u përfshirë në proces vlerësimi dhe priorizimi.
- Unifikohet informacioni mbi zonat e ndotura në 5 rajonet nëpërmjet hartëzimit të niveleve të aksesit të banorëve në këto shërbime.

- Përditësohen të dhënat lidhur me këto shërbime në bazën e të dhënave të autoriteteve përkatëse qendrore dhe vendore.
- Rritet bashkëpunimi midis niveleve të ndryshme të qeverisjeve me rrjetin e shoqërisë civile në funksion të menaxhimit të shërbimeve mjedisore.
- Rritet informimi qytetar në lidhje me aksesin e tyre në sistemin e furnizimit me ujë dhe atij të largimit të ujerave të ndotura.
- OJF dhe individët i referohen organizatave të rrjetit për përvojë në proceset e vlerësimit/monitorimit të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujerave të ndotura.
- Hartëzimi i situatës aktuale të furnizimit me ujë të pijshëm dhe të largimit të ujerave të ndotura të çdo rajoni/zonave pilot mund të përditësohet me informacione të reja çdo vit dhe të shërbejë për hartimin e politikave mbështetëse dhe në proceset vendimmarrëse vendore/rajonale/qendrore.

## Roli i Partnerëve

**Auleda** do të luajë një rol të rëndësishëm në orientimin e politikave në nivel rajonal për mbrotjen dhe përmirësimin e mjedisit. Krahas monitorimit të mjedisit në përputhje edhe me Planin Strategjik të hartojë projekte teknike për investime me synim përmirësim të problemeve mjedisore.

Rol të rëndësishëm në ndërgjegjësim të qytetarëve dhe nxënësve mbi riciklimin si një mënyrë shumë efikase për pakesimin e mbetjeve.

**Roli i FGJ** në rrjet do të sjellë evidentimin të problematikës për “aksesin në ujë” në zonën e Gjirokastrës dhe fshatrave nën juridiksionin e saj. FGJ si partner, do të trajtojë edhe aspekte të tjera si ajo e Ujit dhe mbrojtjes nga zjarri, përdorimi me efikasitet të ujit në Zonat Historike.

**QZHK “Sot për të Ardhmen”** është Organizata partnere e rrjetit, përgjegjëse për implementimin e projektit në qytetin e Durrësit. QZHK “Sot për të Ardhmen” në

projekt ka rolin e menaxhimit dhe implementimit të aktiviteteve në Durrës. Organizata koordinohet dhe bashkëpunon me qeverisjen vendore si Bashkia, Qarku dhe Prefektura Durrës dhe institucionet e referencës, ngre grupet e punës për anketimin, mbledhjen e të dhënave dhe raportimin e tyre të lideri i rrjetit, URI në përputhje me kërkesat dhe unifikimin e të dhënave në rrjet. QZHK “Sot për të Ardhmen” angazhon të rinjtë dhe grupet komunitare si dhe shoqërinë civile dhe institucionet në Durrës në fushatën ndërgjegjësuere për shërbimet publike.

**Tjetër Vizion** do të jetë implementues direkt i këtij projekti. Në partneritet me anetarët e rrjetit, do të mundësojë realizimin e objektivave të projektit dhe rezultateve të tij. Realizimi i aktiviteteve të parashikuara do të rrisë kapacitetet e Tjetër Vizion do të koordinojë dhe bashkëpunojë me NJQV dhe institucionet përgjegjëse të aktiviteteve të projektit dhe do të raportojë në mënyrë periodike tek lideri i rrjetit, URI. “Tjetër Vizion” për të qenë gjithnjë i pranishëm e vigjilent në territor, për të sensibilizuar dhe ndërgjegjesuar opinionin e gjerë publik dhe NJQV me qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe stimulimin e programeve të zhvillimit me karakter komunitar.

**“Unë, Gruaja” (UG)** do të manaxhojë projektin gjatë gjithë kohëzgjatjes së tij. UG do të realizojë me cilësi të gjitha aktivitetet e planifikuara brenda afateve kohore të përcaktuara. UG do të marrë pjesë në të gjitha aktivitetet e përbashkëta të rrjetit. UG do të promovojë në kuadër të projektit nisma të përbashkëta me rrjetin për përmirësimin e shërbimeve nga bashkia dhe zbatimin e politikave lokale mjedisore në përputhje me ligjet në fuqi, etj. Do të bashkëpunojë sistematikisht me bizneset vendase dhe me mediat lokale për promovimin e projektit 3-vjeçar në kuadër të programit Seniora, duke nxitur vazhdimësinë e tij në të ardhmen. Në të njëjtën mënyrë do të përdoren rrjetet sociale dhe faqja zyrtare web: [www.unegruaja.org](http://www.unegruaja.org).

## Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojshmëri qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur/ Fondacioni Soros, etj.

## FAKTET KRYESORE

### DONATOR:

- ✓ Qeveria Suedeze/REC

### PARTNERET:

- ✓ AULEDA, Vlorë
- ✓ FONDACIONI GJIROKASTRA, Gjirokastrë
- ✓ CDC “Sot për të ardhmen”, Durrës
- ✓ TJETER VIZION, Elbasan
- ✓ UNE GRUAJA, Pogradec

### KOHËZGJATIA:

1 shkurt 2015-15 tetor 2015

### PËRFITUESIT:

- ✓ Qyteti i Durrësit
- ✓ Qyteti i Vlorës
- ✓ Qyteti i Pogradecit
- ✓ Qyteti i Gjirokastrës
- ✓ Qyteti i Elbasanit
- ✓ Banorët e këtyre qyteteve
- ✓ Drejtorja e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime (DPUK)
- ✓ Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

### KONTAKT:

- ✓ Mirela Koci, Drejtore Ekzekutive AULEDA
  - ✓ Sadi Petrela, Drejtor i FGJ
  - ✓ Fabiola Laço – Egro, Drejtore Ekzekutive CDC
  - ✓ Afroviti Gusho, drejtuese projekti UG
  - ✓ Arian Cala, Drejtor Ekzekutiv Tjetër Vizion
  - ✓ Mirela Koci, Drejtore Ekzekutive, auleda
  - ✓ Zana Vokopola Drejtore Ekzekutive Instituti i Kërkimeve Urbane
- Rr. Asim Vokshi, Nd.14  
Hyrja 11, Ap. 56  
Tiranë  
Tel: +355 4 2256840  
E-mail: [uri@uri.org.al](mailto:uri@uri.org.al)